

VENDIM
Nr.444, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 881, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE
DHE PËR STRUKTURËN E NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE
TË JASHTME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, miratuar për vitin 2009.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Pozicioni drejtues	Grada diplomatike	Paga mujore			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa për gradë
		2	3	4	5
	1	Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Sekretar i Përgjithshëm	Ambasador	12 000	2%		115 000
Drejtor i Përgjithshëm	Ministër Fuqplotë Ministër Këshilltar Konsull i Përgjithshëm	12 000	2%		105 000
Drejtor	Këshilltar	12 000	2%		88 000
Përgjegjës sektori	Sekretar i parë Konsull	12 000	2%		69 000
	Sekretar i dytë Zëvendëskonsull	12 000	2%		52 000
	Sekretar i tretë	12 000	2%		41 000

	Agjent konsullor				
	Atashe	12 000	2%		31 000